

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "FOXSERVICE"

Në Durrës, sot në datën 22/ Janar/ 2022, une Gianpiero Flauto, atësia Mario, shtetas italian, lindur në Napoli (NA) Itali, banues në Massarosa (LU), lindur më 16/Maj/1972, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me pasaporte nr. YB7474660, lëshuar në datën 30/Nentor/2021 nga Republika e Italisë, bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i azhornuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" etj, **themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar "FOXSERVICE" sh.p.k.**

Selia e shoqërisë është në Durrës, në adresën lagja nr. 1, rruga "Kont Urani", Vila Kaizer, pranë Vila e Zogut", Apartamenti 5/1.

Objekti i shoqërisë është: Shërbime konsulence dhe marketingu. Tturizëm, reklamime, dhenia me qira e mjeteve motorrike, dhenia dhe marrja me qira e pasurive të paluajtshme për banim dhe të ambjenteve komerciale, shitja e biletave ajrore dhe të tragetit.

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është **pa afat**.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1'000 (një mijë) lekë, i përbërë nga 1 kuotë, me 100 % pjesëmarrje dhe do të zotërohet nga unë ortaku i vetëm themelues Gianpiero Flauto.

Shoqëria do të shtrijë aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë. Me Vendim të Asamblesë së përgjithshme mund të ndryshohet, krijohen ose anulohen në rast se janë çelur, Seli, Filiale, Agjenci dhe perfaqësi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë.

Administrator i shoqërisë emërohet z. Gianpiero Flauto, i cili deklaron se pranon rolin e ngarkuar dhe se nuk ekzistojnë shkaqe të ligjshme që mund ta shpallin të pavlefshme.

Afati i emërimit të administratorit është pesë vjet. Administratori emërohet sot në datën e nënshkrimit të aktit të themelimit. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit ne Qendrën Kombetare të Regjistrimit (Neni 95, pika e parë e Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare")

Administratori përfaqëson shoqërinë tregtare, kryen veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politika tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.

Në rastet e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe që lidhen me transaksione të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit themeltar, venie garancie hipotekore apo bankare, marrje kredie, marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombetare, Administratori i emëruar kryen veprime bankare vetëm mbi bazën e Vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, i cili duhet të jetë legalizuar nga Noteri.

Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie ligjore ose testamentare sipas dispozitave të Kodit Civil. Ortaku gëzon të drejtën e shitjes se kuotave jashtë ortakërisë mbi bazen e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas procedurave që janë përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi redaktohet në tre njësi origjinale, me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet me zë miratohet nga unë ortaku i vetëm themelues.


